



Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit

Nr.07/351/01-15107

Dt. 23.06.2017

Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit duke vendosur sipas kërkesës së parashtruar nga: **Bajram (Daklan) Lila dhe Shuhrete (Miftar) Fila** nga Gjakova, për dhënien e Lejes së Ndërtimit për ndërtimin e objektit të kategorisë së parë, me destinim objekt i banimit individual, me etazhitet B+P, në bazë të Ligjit për Ndërtim, Nr. 04/L-110, nenet 14, 15, 19, 20 dhe 21 si dhe Ligjit për Procedurën Administrative Nr. 02/L-28 nenit 11, bien këtë:

AKTVENDIM

I. I LEJOHET: aplikuesit: Bajram (Daklan) Lila dhe Shuhrete (Miftar) Fila nga Gjakova, ndërtimi i objektit të kategorisë së parë, me destinim - objekt i banimit individual, sipas Projektit Kryesor të prezantuar, në përputhshmëri me Planin Rregullues Urban "Kompleksi në rrugën Tirana - Tranziti" dhe Kushtet Ndërtimore me nr. 07-351/01-11211, të datës 26.05.2017, të lëshuar nga DUMM, në ngastrën kadastrale me nr. 5776/0, Z.K. Gjakovë -J- Qytet, në rrugën "Tirana", në pronësi të lartë përmendurit, e cila ka vijën e ndërtimit dhe rregullimit të definuar dhe të prezantuar në planin e situacionit me të gjithë parametrat tjerë përcjellës për ndërtimin e objektit në fjalë, etazhiteti i objektit është B+P, me sipërfaqe të përgjithshme (bruto) të objektit $S=167.87 \text{ m}^2$.

Bodrumi: (Sip,Bruto): $S= 23.12 \text{ m}^2$

Përdhesa: (Sip,Bruto): $S= 144.75 \text{ m}^2$

II. Hartimin e projektit me destinim: ndërtimi i objektit të banimit individual, nga pika 1 e këtij aktvendimi e ka bërë ndërmarrja projektuese "GONI - ING" Suharekë.

IV. Pjesë përbërëse e këtij aktvendimi është Plan Situacioni i lokacionit me objektin sipas vijës së ndërtimit dhe rregullimit, e përshkruar në situacionin grafik për të cilin është dhënë pëlqimi përkatës nga kjo drejtori i cili është bazë për rilevimin gjeodezik të objektit nga pika 1 e këtij aktvendimi.

V. Investitori është i obliguar:

- Që të ruaj një ekzemplar origjinal të dokumentacionit teknik në bazë të të cilit i është dhënë kjo Leje Ndërtimi;
- Që pa pëlqimin e hartuesit të projektit kryesor dhe pëlqimin e kësaj Drejtorie, të mos bëjë asnjë ndryshim në projekt;
- Ekzekutimi i punimeve nga pika 1 e këtij Aktvendimi, të realizohet nën mbikëqyrjen e organit mbikëqyrës për realizimin e ndërtimit të objektit.
- Të lajmëroj Drejtorinë e inspektionit për ditën e fillimit të punës së paku 8(tetë) ditë para fillimit të ndërtimit, me qëllim të verifikimit dhe përcjelljes së punimeve:

VI. Kjo Leje Ndërtimi vlen 1(një) vit nga dita e lëshimit të këtij aktvendimi.

Arsyetim

Bajram (Daklan) Lila dhe Shuhrete (Miftar) Fila nga Gjakova, me banim në rrugën "Ali Pashë Tepelena" nr.pn. ka parashtruar kërkesën pranë DUMM me nr. 07/351/01-15107 të datës 15.06.2017 për dhënien e Lejes së Ndërtimit për ndërtimin e objektit të kategorisë së parë, me destinim objekt i banimit individual, me etazhitet B+P, në ngastrën kadastrale me nr. 5776/0, Z.K. Gjakovë –J- Qytet, në rrugën "Tirana", në pronësi të lartë përmendurit, siq është përshkruar në pikën 1 të dispozitivit të këtij aktvendimi.

Së bashku me kërkesën investitori e ka prezantuar edhe këtë dokumentacion:

1. Planin e Situacionit në përpjesë 1:500 të datës 01.03.2017, të punuar nga NPSH "GELI- Gjakovë.
2. Kopjen e planit të datës 05.05.2017 në pronësi të Bajram (Daklan) Fila dhe Shyhrete (Miftar) Fila, me nga ½ (pjesë ideale), të lëshuar nga Drejtoria për Kadastër Gjeodezi dhe Pronë.
3. Çertifikaten mbi të drejtat në pronën e paluajtshme me nr. të lëndës 261/17 të datës 05.05.2017, të lëshuara nga Drejtoria për Kadastër Gjeodezi dhe Pronë.
4. Kushtet Ndërtimore, me nr. 07-351/01-11211 të datës 26.05.2017, për rregullimin e hapësirës për ndërtimin e objektit të banimit individual, në ngastrën kadastrale me nr. 5776/0, ZK: Gjakovë –J- Qytet, të lëshuar nga DUMM.
5. Deklaratën Noteriale, me nr Akt en Brevet LRP.nr.2058/2017. Dt.08.06.2017.
6. Pëlqimin për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore, me nr. 08-320-01-14832, dt.12.06.2017, nga Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural.
7. Vërtetimin mbi kryerjen e obligimeve nga tatimi në pronë, nr 430-b-378 të datës 12.06.2017.
8. Pëlqimin nga KEDS - Gjakovë, të datës 05.06.2017.
9. Pëlqimin nga K.R.U."Radoniqi"Sh.A.Gjakovë, nr. 1728, dt.31.05.2017.
10. Pëlqimin nga PTK-Gjakovë, dt. 30.05.2017.
11. Dëshminë mbi kryerjen e obligimeve nga taksa administrative dhe tarifa rregullative për rritjen e densitetit në Posta e Kosovës, filiala Gjakovë me datë 22.06.2017.
12. Projektin kryesor në 3 (tri) kopje, ndërmarrja projektuese "GONI - ING" Suharekë.

Taksa administrative dhe tarifa rregullative për rritjen e densitetit është paguar në vlerën prej 782.23 Euro.


KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij Aktvendimi, pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afatin prej 30 ditësh, duke u llogaritur nga dita e marrjes në dorëzim. Ankesa i parashtrohet Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor në Prishtinë, dhe e njëjta dorëzohet nëpërmjet kësaj Drejtorie.


Aktvendimi i dorëzohet:

- Investitorit,
- Drejtorisë së Inspektionit,
- Arhivës.

Zyrtar i lartë për çështje juridike


Zenel Shabani, jur.dipl.

U.D. Drejtori


Elida Bejtullahu, inxh.e dipl.e ark.

Kuvendi Komunës GJAKOVË
Drejtoria për Kadastër Gjeodezi dhe Pronë

KOPJE PLANI

Zona kad. Gjakovë-Jasht- Qytet

Shk. zvog. 1: 500

Poseduesi: 1 /2 Fila Bajram (Daklan), 1 /2 Fila Shuhrete (Miftar),
nga Gjakova



Numri rendor i regjistrit të taksave kadastrale: _____


Nr. Parcelës	Plani	Vendi i quajtur	Kultura	Klasa	Sipërfaqja			Vërejtjet
					Ha	a	m ²	
5776			Arë	4	0	03	05	
					0	03	05	

Që kjo kopje e planit është besnike e origjinalit të vet sipas gjendjes në kadastrë duke paguar taksën sipas vendimit të KK GJAKOVË.



K.K. GJAKOVË
Z.K. : Gj.j. Qytet
Ng. nr. 5776-0

PLAN SITUACIONI P=1:500



— Gjendja Kadastrale
— Gjendja Faktike

Lokacioni: Bajram Fila

Gjakovë, 26.05.2017

punoi: Fatmir Bobi, tek.gjeod.

vërtetoi: Agron Gojani, i.d.a.

Gjakovë,
28.04.2017
Auto CAD 2004

Punoi : Xhelal F. Zhubi inxh. i dip.
i gjeod.

Vërtetoi: N.P.SH. " GELI" Gjakovë

Firro Hajdaraj